



DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA

C-I.-24-0010

Paditës - Propozues:

H H Z B nga f.sh I K.Deçan
Përfaqësuar nga Av.B I avokat nga Prishtina.

Kundër:

Të paditura – Pala kundërshtare:

N.SH “Veselin Maslesha”, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte –Prishtinë,

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtari Murat Hulaj kryesues, Sylejman Shumolli dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.06.06.2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Kërkesa e paditësve - propozimi për masë të sigurimit, Refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.24 maj 2024, në DHPGJS, i autorizuari i paditësit av. B I, ka paraqitur padi me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, kundër të paditurës N.SH “Veselin Maslesha”, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Në padi ka theksuar se Bordi i Drejtorëve i AKP-së me dt.29.03.2024, kishte nxjerr Vendimin Ref.BD-200/16 lidhur me statusin e asetëve të ish Ndërmarrjes Botuese “Veselin Maslesha”, Sarajevë KPS1543/PRN2013. Ky bord ka gjetur se të gjitha asetet e kësaj ndërmarrje janë pronë shoqërore dhe bien nën kompetenca të AKP-së. Në njoftimin e AKP-së të dt.22,23,24,25 dhe 26 prill 2024, palëve të interesuara u është dhënë sqarim se mund të paraqesin ankesë kundër këtij vendimi. Paditësi ka interes legjitim pronësor, pasi që është aksionar i ish NSH-së, e cila

pas privatizimit quhet Shoqëria Librare dhe Tregtare “Libraritë Maslesha” shoqëri aksionare në Sarajevë.

Ka shtuar se ish NSH “Veselin Maslesha”, nga Sarajeva kishte blerë lokale afariste nga ish Ndërmarrja Komunale e Banesave Prishtinë, dhe pastaj e kishte regjistruar filialen e saj në Kosovë. Pas fillimit të procesit të privatizimit, kjo ndërmarrje u kishte ofruar në shitje punëtorëve të saj aksione interne, dhe ata të cilët e kishin nënshkruar kontratën për blerjen e tyre e ka lënë një pjesë të pagës peng, ashtu siç kishte vepruar paditësi. Aksionet shiteshin dhe bliheshin duke nënshkruar kontratë të veçantë duke e specifikuar numrin e aksioneve. Për shkak të situatës që e ka sjellë lufta, aksionarët dhe punëtorët e ndërmarrjes ju drejtuan kompanisë bazë me shkresë dhe kërkuan që të iu sqarohen autorizimet e tyre, nga të cilët morën përgjigje që të vazhdonin veprimtarin. Afati për privatizimin e kësaj ndërmarrje ishte 10 vjeçar, ashtu që nga viti 1991 deri në vitin 2001, është privatizuar dhe Agjencioni Kantonal i Privatizimit në Sarajevë, kishte vendosur që ky subjekt afaristë mund të regjistrohet në regjistrin e kompanive private në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ndërmarrja Publike Banesore me Vërtetimin nr.02-506 dt.13.03.2015 ka vërtetuar se në bazë të kontratës nr... dt... është bërë bashkimi i mjeteve për blerjen e lokalit afaristë i cili gjendet në rr. “D” BL-5 L-E-I-3, lokali nr., në sip.prej 81.19m2 mes Ndërmarrjes Publike Banesore sh.a Prishtinë dhe IRO – “Veselin Maslisha” – Sarajevë. Kjo ndërmarrje i ka kryer obligimet financiare ndaj ndërmarrjes banesore sipas kontratës nr... dt....

Ndërmarrja banesore ka lëshuar konfirmimin nr.prot... dt..., me të cilin ka konfirmuar lidhjen e kontratës në mes të këtyre dy ndërmarrjeve, dhe se janë përmbushur obligimet financiare. AKP me dt.23.10.20223 i ka dërguar palës shkresë – vërejtje me titull “Shfrytëzimi i aseteve në pronësi shoqërore”.

Ka shtuar se kjo ndërmarrje është privatizuar konform dispozitave ligjore dhe është regjistruar në regjistrin gjyqësor me kapital privat sipas aktvendimit të dt.31.07.2001.

Ka kërkuar nga gjykata që të caktoj masën e ndalimi të shitjes, privatizimit, apo shitjes me likuidim e tjetërsim apo ngarkim të ndonjë drejte sendore të ish NSH “Veselin Maslesha”, përkatësisht të ndalohet ndryshimi i gjendjes juridike dhe faktike në asete apo lokalin afaristë derisa të vendoset me aktgjykim të plotfuqishëm. Kërkesa për masë është bërë e besueshme në bazë të provave të paraqitura, kurse me privatizimin eventual do të shkaktohej dëm i pa riparueshëm paditësit, pasi që AKP mund ta shes shumë shpejt këtë pronë shumë vonë do ta nënshkruaj kontratën.

Padisë i ka bashkangjitur këto prova:

- Njoftim i dt.22,23,24,25 dhe 26.04.2024,
- Kontratë nr... dt...,
- Deklaratë,
- Kontratë dt... ,
- Përgjigje në kërkesën nr.NH/103/99 e dt.08.09.1999,
- Aktvendim nr.21-04/3-19-324-5 dt.31.07.2001,
- Vërtetim nr, dt...,

- Fletëtransferi i pagesës së tatimit në pronë dt.,
- Fatura e tatimit në pronë në emër të paditësit dt.,
- Konfirmim nr... dt...,
- Shkresë me titull “Shfrytëzimi i aseteve në pronësi shoqërore” nr.2643/2023 dt.23.10.2023.

E paditura - kundër propozuesja AKP, me dt.31 maj 2024, ka paraqitur përgjigjen e saj, në kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, ku ka pohuar se: e kundërshton propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Në përgjigje te urdhrin të gjykatës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, në lidhje me kërkesën për aprovimin e masës së sigurisë. AKP ndër të tjera pohoi se e kundërshton propozimin për caktimin e masës së sigurisë pasi i njëjti nuk mbështetet në prova relevante dhe të besueshme. AKP i propozoi gjykatës që të hedh ose refuzoj në tërësi si të pabazuar në ligj propozimin e parashtruesit.

Arsvetimi Ligjor

Kërkesa për masë të sigurimit është e pabazuar.

Sipas nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cila kërkon urdhër paraprak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek paditësit, kështu që paditësit përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Ekzistimi i së drejtës së pretenduar

Pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, Kolegji vlerëson se paditësit në këtë fazë të procedurës, nuk kanë dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tyre. Pretendimet e paditësit se pronën kontestuese e kanë fituar në bazë të vendimit me nr.464-764/91 dt.01.09.1992 të Këshillit Ekzekutiv të Komunës së Fushë Kosovës nuk mund të merret si provë për caktimin e masës së sigurisë. Mbi bazën e këtij vendimi nuk mund të konstatohet ekzistimi i të drejtës së saj të pretenduar. Aq më pak kur në certifikatës së pronësisë si posedues – pronar të parcelave kadastrale figuron N.P Victoria Invest International SH.P.K.

Dëmi i menjëhershëm

Gjykata vlerëson se nuk është plotësuar as kushti për dëm të menjëhershëm për caktimin e Masës së sigurimit, pasi që paditësit nuk e ka paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritet të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe se nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

Dëmi i pariparueshëm

Sipas dispozitave ligjore dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Në rastin konkret, as kushti për dëm të pariparueshëm, si kusht për tu caktuar masa e sigurimit nuk është plotësuar.

Në këtë rast gjykata nuk ka gjetur se kërkesa e paditësit për Masë të Sigurimit mund të ketë mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u refuzua.

Shpenzimet Gjyqësore

Paditësi tani më ka paguar taksën gjyqësore për kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme Brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Murat Hulaj Gjyqtar kryesues _____

Sylejman Shumolli Gjyqtar _____

Agron Hoxhaj Gjyqtar _____